

KONTRATE PER SHITBLERJEN E KUOTAVE

Kjo Kontrate per Shitblerjen e Kuotave (ne vijim "Kontrata") lidhet sot me 12.12.2022

ndërmjet:

Z. Esterino Ceria, shtetas Italian, lindur në Torino, më 25.10.1946, banues në Kamez, Tirane identifikuar nëpërmjet pasaportes me nr. YB6841612 (referuar me poshte si "Shitesi")

dhe

Vëllezërit e Hekurt Estate sh.p.k, shoqeri e te drejtes shqiptare, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS L81617013R, me seli ligjore ne Rruga Teksas, Nd. 87, Ap. 23, Shk. 2, Kamëz, perfaqesuar nga administratori Z. Esterino Ceria (referuar me poshte si "Bleresi")

Shitesi dhe Bleresi do te referohen me poshte edhe si "Palet".

Meqenese:

A. Shitësi zotëron 90% (nentedhete përqind) te kapitalit te shoqerise "Greenpanel" sh.p.k, shoqeri me përgjegjesi të kufizuar e themeluar në perputhje me legjislacionin e Republikës së Shqiperisë, NIPT L81611045B, me seli ne Vore, Fshati Picar, Zona kadastrale nr.3974, numer pasurie 166/84, volum 6, faqe nr.69, me kapital te regjistruar prej 100,000,00 (njqind mije) Leke.

B. Bleresi kërkon të blejë 90% (nëntëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqerise "Greenpanel" sh.p.k, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar në perputhje me legjislacionin e Republikës së Shqiperise, NIPT L81611045B me Vore, Fshati Picar, Zona kadastrale nr.3974, numer pasurie 166/84, volum 6, faqe nr.69, me kapital te regjistruar prej 100,000,00 (njqind mije) Leke.

Per sa me siper, Palet bien dakort per sa vijon.

Neni 1

Hyrja

Hyrja eshte pjese perberese dhe thelbesore e kesaj Kontrate.

Neni 2

Transferimi i Kuotave

2.1 Ne perputhje me afatet dhe kushtet te kesaj Kontrate, ne daten e sotme Shitesi i shet Bleresit qe pranon dhe blen 90% (nentedhete perqind) te kapitalit te shoqerise "Greenpanel" sh.p.k (ne vijim "kuotat")

2.2 Kuotat kalohen me vullnet te lire dhe te plote.

Neni 3

Çmimi dhe menyra e pageses

Çmimi per shitblerjen e Kuotave eshte percaktuar ne shumen fikse gjithe perfshirese dhe te pandryshueshme prej 120,000 (njqind e njetzet mije) leke qe Bleresi i transferon Shitesit njekohesisht me nenshkrimin e kesaj Kontrate nepermjet transfertes bankare ne llogarine e Shitesit.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci te Shitesit

Shitesi i ben Bleresit deklaratat dhe garancite si vijon, qe jane te verteta dhe te sakta ne daten e nenshkrimt te kesaj Kontrate:

- (a) Shitesi ka kompetencat e duhura per te nenshkruar rregullisht dhe permbushur kete Kontrate;
- (b) nenshkrimi i kesaj Kontrate dhe permbushja nga ana e Shitesit te detyrimeve ne ngarkim te tij ne te nuk perbejne shkelje te asnje dispozite ligjore detyruese per Shitesin dhe shkelje te dispozitave te vendimeve te autoriteteve gjyqesore ose te autoriteteve te tjera;
- (c) Shitesi zoteron plotesisht dhe i vetem Kuotat, te lira nga pengu, sekuestro, te drejta uzufukti, barra, detyrime, te drejta parablerje ose te tjera te drejta te te treteve te çdo lloj natyre dhe ka te drejte te plote t'ia transferoje te treteve ne çdo menyre perfshire shitjen e tyre;
- (d) Shitesi ka marre te gjitha vendimet dhe nismat e tjera te nevojshme te shoqerise per te nenshkruar vlefshmerisht dhe permbushur kete Kontrate.

Neni 5

Deklarime dhe Garanci te Bleresit

Bleresi i ben Shitesit deklarata dhe garancite si vijon, qe jane te verteta dhe te sakta ne daten e nenshkrimt te kesaj Kontrate:

- (a) Bleresi eshte nje shoqeri rregullisht e themeluar ne perputhje me legjislacionin zvicerian dhe ka te gjitha te drejtat dhe kompetencat e duhura per te nenshkruar rregullisht dhe permbushur kete Kontrate;
- (b) nenshkrimi i kesaj Kontrate dhe permbushja nga ana e Bleresit te detyrimeve ne ngarkim te tij ne te nuk perbejne shkelje te asnje dispozite ligjore detyruese per Bleresin dhe shkelje te dispozitave te permbajtura ne vendime te autoriteteve gjyqesore ose te autoriteteve te tjera;
- (c) Bleresi ka marre te gjitha autorizimet dhe lejet qe ne perputhje me ligjin jane te nevojshme per nenshkrimin e kesaj Kontrate;
- (d) Bleresi ka marre te gjitha vendimet dhe nismat e tjera te nevojshme te shoqerise per te nenshkruar kete Kontrate.

Neni 6

Efektet e Kontrates


6.1 Palet deklarojne se Bleresi fiton pronesine mbi kuotat nga data e kesaj kontrate.

6.2 Duke nisur nga data e kesaj kontrate Bleresi behet keshtu ortak i 90% (nentedhete perqind) i kuotave te kapitalit te Shoqerise "Greenpanel" sh.p.k dhe shitesi humbet pronesine mbi kuotat e kapitalit.

Neni 7

Dispozita te pergjithshme

7.1 Kjo Kontrate dhe te gjitha transaksionet e parashikuara ne te do te rregullohen, interpretohen dhe do te jene te ekzekutueshme ne perputhje me ligjet e Shqiperise



7.2 Ne rast mosmarveshje te paleve mbi kushtet, detyrimet dhe interpretimin e kesaj kontrate, palet do te bejne te gjitha perpjekjet e mundshme per ti zgjidhur me mirekuptim. Ne rast te kundert Gjykata e Tiranes do te jete kompetente per zgjidhjen e ketyre mosmarveshjeve.

7.3. Kjo Kontrate eshte pergatitur ne 3 (tre) kopje qe kane te njejten vlere juridike.

7.4. Kjo Kontrate hyn ne fuqi me firmosjen nga palet, te cilat firmosin kete marveshje ne daten e percaktuar me lart.

SHITESI

Z. Esterio Ceria

Ceria Esterio



BLERESI

Vëllezërit e Hekurt Estate

Ceria Esterio

